



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:133684

Datë: 28.12.2020

Numri i dokumentit: 01375967

C.nr.551/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Florije Qerimi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditëses K. e S. KS , Sh.A, me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit I. (R.) H nga Gjilani, me objekt kontesti rimbursim i borxhit, me vlerë të kontestit, 259.00 €, jashtë seancës gjyqësore, më datën 07.12.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË MOSBINDJES

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. e S. KS, Sh.A me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri I. (R) H nga Gjilani, që paditëses t'ia kompensojë mjetet në emër borxhit shumë e përgjithshme për rimbursim në lartësi prej 259.00€(dyqindë e pesëdhjetë e nëntë euro), me kamatëvonesë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 07.12.2020, si datë e marrjes – pranimit të aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 €, të gjitha në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë më datën 21.06.2019, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për pagimin-rimbursimin e borxhitt në shumë prej 259.00 €(dyqindë e pesëdhjetë e nëntë euro) me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjyqësore për aq sa do të krijoheshin, në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në padi e njejta ka theksuar se me datë 26.05.2016 ka ndodhur aksident komunikacioni në lagjen në Gjilan kur mjeti „A” (i siguruar për TPL në SIGAL) ka qenë duke qarkulluar në lagjen , dhe se me të arritur përballë qebaptores nga mosekesperienca i bartet motoçikleta e tij dhe e godet mjetin B me targa të regjistrimit ... që ishte i parkuar në vendin përkatës për parking të cilit i shkakton dëme materiale dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

Sipas pretendimeve të paditëses, e cila e ka kompensuar të dëmtuarin L. R, në bazë të M.rëveshjes Jashtëgjyqësore, në shumë prej 259.00 €, i padituri në atë kohë kishte drejtuar

automjetin pa patent shofer, me çka është vërtetuar se i njejt i nuk ka pasur të drejtë të ngasë automjeten me të cilin ka shkaktuar dëmin, ka humbur mbulesën siguroese dhe për këtë paditësja ka të drejtë që mjetet e paguara nga kjo bazë t'i regresoj drejtpërdrejtë nga shkaktari i dëmit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.269/18, të cilin i padituri e ka pranuar me dt.23.07.2019, (e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar personalisht aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”*

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë e ka vërtetuar faktin se i padituri më dt. 26.05.2016, ka shkaktuar aksident trafiku, ku të njëjti i bartet motoçikleta dhe e godet mjetin B me targa ... që ishte parkuar në vendin përkatës për parking e të cilit i shkakton dëme materiale në pjesën e parme nga ana e djathtë i dëmtuar treguesi i drejtimit dhe pjesa e pasme ana e djathtë po ashtu i dëmtuar i gërvishitur, dhe i njejt i lëshon vendin e shkaktimit të dëmit, fakt që vërtetohet nga raporti policorë i aksidentit Nr....

Si rezultat i këtij aksidenti të dëmtuarin e lartë cekur K. e S KS . Sh.A me seli në Prishtinë, në bazë të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, në nenin 960 par.1 në të cilin përcaktohet se *„ Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguroesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të sigurvearit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”* i ka kompensuar të dëmtuarit dëmin material të pësuar nga aksidenti i trafikut, fakt i vërtetuar përmes Ujdisë Gjyqësore të datës 01.03.2016, si dhe nga Urdhërtransferi Bankar i datës 30.06.2016.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së dhe në lidhje me dispozitat e nenit 14 par.2 dhe 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku parashihet se „ *Humb mbulesa siguruese e policës së sigurimit kur drejtuesi i mjetit që shkakton aksidentin është nën ndikimin e alkoolit apo i pa pajisur me dëshminë adekuate për drejtimin e një mjete të tillë*”. meqë shkaktori i aksidentit ka qenë i siguruari tek paditësja , zhdëmtimet janë bërë nga ana e paditëses, por pasiqë drejtuesi i mjetit (motoçikletës) ka qenë pa patentë shofer e që nuk ka pasur të drejtë të drejtojë mjetin motorik me të cilin ka shkaktuar dëmin ka humbur mbulesën siguruese andaj gjykata obligoi të paditurin që t’ia rimburojë mjetet paditëses për dëmin e shkaktuar .

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet taksës gjyqësore në shumë prej 20 eurove.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.551/19, më datë 07.12.2020**

**Gjyqtarja
Florije Qerimi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.